



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 01.12.2015

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË FUNKSIONIT TË ISH-GODINËS SË DOGANËS  
TIRANË NË LABORATOR DOGANOR DHE MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT  
PËR OBJEKTIN: "RIKONSTRUKSION I LABORATORIT DOGANOR", BASHKIA  
TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të funksionit të ish-Godinës së Doganës Tiranë në Laborator Doganor.
2. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Rikonstruksion i Laboratorit Doganor", Bashkia Tiranë, me subjekt kërkues Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) pajisjes me dokumentin përkatës mjedisor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



A circular official stamp in blue ink is partially obscured by a handwritten signature in blue ink. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" at the top, "MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN" on the sides, and "TIRANË" at the bottom. The signature is written in a cursive style across the stamp.

**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**



A circular official stamp in blue ink is partially obscured by a handwritten signature in blue ink. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" at the top, "MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN" on the sides, and "TIRANË" at the bottom. The signature is written in a cursive style across the stamp.